



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 25 Janar 2022

Nr: 3

V E N D I M

P Ë R

DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR,
“PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË
SHTETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS
NË KZAZ DHE KQV”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në KZAZ dhe KQV”, bëhen shtesat si më poshtë vijon:
 - a) Pas pikës 3, të nenit 5, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim të veçantë përcakton afatet dhe procedurat për emërimin kryesisht të anëtarëve/sekretarëve të KZAZ-së.”.
 - b) Pas pikës 3, të nenit 10, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim të veçantë, përcakton afatet dhe procedurat për emërimin kryesisht të anëtarëve/sekretarëve të KQV-së.”.



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**

